



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. 191 / prot.
180

Tiranë, më 30.9.2025

V E N D I M
Nr. 354, datë 30.9.2025

**PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË LËNDËVE KRYESORE TË VITIT TË PARË TË
PROGRAMIT TË FORMIMIT FILLESTAR PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026**

Në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", nenet 248, 263, si dhe në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 30.9.2025,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e lëndëve kryesore të vitit të parë të Programit të Formimit Fillestar për vitin akademik 2025-2026, sipas materialit bashkëngjitur, pjesë e pandarë e këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Tabela nr. 1. Lëndët kryesore të vitit të parë

NR.	LËNDËT	ORËT
1.	GJYKIMI CIVIL	150
2.	GJYKIMI FAMILJAR, I MITURI DHE VIKTIMA	100
3.	HETIMI DHE GJYKIMI PENAL	150
4.	GJYKIMI ADMINISTRATIV	130
5.	GJYKIMI KUSHTETUES	60
6.	DREJTËSIA EVROPIANE	92
7.	ETIKA PROFESIONALE	80
8.	AFTËSI DHE MENAXHIM	112
	Modul 1: Menaxhimi i gjykatës dhe digjitalizimi	40
	Modul 2: Arsyetimi ligjor dhe mendimi kritik	52
	Modul 3: Aftësitë për prezantimin e çështjes në gjykatë dhe drejtimin e seancës gjyqësore	20
9.	MODULE TË SPECIALIZUARA	115
	Modul 1: E drejtë e mjedisit	30
	Modul 2: Kontratat	25
	Modul 3: Gjykimi i mosmarrëveshjeve të punës	25
	Modul 4: Gjykimi tregtar dhe kompanive	35
	Gjithsej	989

Lëndët e vitit të parë ndahen në dy grupe:

- a. Lëndë të grupit të parë, ku përfshihen:
 1. Gjykimi civil;
 2. Gjykimi familjar;
 3. Hetimi dhe gjykimi penal;
 4. Gjykimi administrativ;
 5. Gjykimi kushtetues.
- b. Lëndë të grupit të dytë, ku përfshihen:
 1. Drejtësia Evropiane;
 2. Etika profesionale;
 3. Aftësi dhe menaxhim;
 4. Module të specializuara.